



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008), dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr.110 - 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 15.2.2016, miratoi këtë

V E N D I M

I.

Me këtë vendim i rekomandohet Kryetarit të Komunës që të nxjerrë vendim për pagesën e anëtarëve të Komisionit për emërtimin e rrugëve.

II.

Në pajtim me pikën 1 të këtij vendimi, kërkohet nga Kryetari i Komunës që, në bashkëpunim me drejtorinë kompetente, brenda një afati të arsyeshëm kohor, të bëjnë ekzekutimin e pagesave për anëtarët e Komisionit për emërtimin e rrugëve.

III.

Ky vendim hyn në fuqi 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljes dhe në ueb-faqen e Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr.400-52528, më 04.03.2016

